

**STATUTI**  
**I SHOQERISE TREGTARE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR**  
**“EMMECI- Fire Protection” SHPK**

Në bazë të Ligjit Nr. 9901 date 14-04-2008, “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”, me vullnet të lirë dhe të plotë ortaket e mëposhtëm hartojë dhe nënshkruajë statutin e shoqërisë të themeluar nga:

**Z. Marco ZAMBETTI**, shtetas huaj, atësia Roberto, lindur në Itali në 02-02-1980, banues aktualisht në Tiranë, madhor, me zotësi të plotë juridike dhe për të vepruar, i identifikuar me pasaporte me Nr. YA6374939, cel 0697506715.

**Z. Nicolo CRIPPA**, shtetas huaj, atësia Enrico, lindur në Itali në 22-08-1975, banues në Itali, madhor, me zotësi të plotë juridike dhe për të vepruar, i identifikuar me karte identiteti me Nr. AY5874059, cel 0699613257, të cilet nuk dine dhe nuk kuptojne shqip ne prani te perkethyeses se zgjedhur nga vete ortaket zj. Isida Robert LEKORGO, me nr. personal I55408091K.

Për të bere të mundur veprimtarinë ekonomike dhe organizimin e kësaj shoqërije e për vijimin e funksionimit dhe detyrimi ne baze të ligjit nr. 9901 date 14-04-2008, “Për Tregtarët dhe Shoqëritë tregtare”, është përpiluar ky statut si më poshtë.

**Neni 1**

Dispozita të Pergjitheshme

Ortakët pjesëmarrës ka krijuar një shoqëri tregtare me përgjegjësi të kufizuar.

Shoqëria e fiton të drejtën e personit juridik ne momentin e regjistrimit të saj në Qendrën Kombëtare të Bisneseve.

**Neni 2**

Shoqëria me përgjegjësi të kufizuar, do të regjistrohet në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit të Bisneseve (QKB) me emrin “EMMECI - Fire Protection” Sh.p.k (në vijim “**Shoqëria**”).

**Neni 3**

Objekti i veprimtarisë të shoqërisë tregtare “EMMECI- Fire Protection” Shpk do të jete :

- a) Kompania do të veproje në fushën e konsultimit, hulumtimit, tregtimit të sistemeve të lëvizshme dhe fikse kundra zjarrit, sistemeve elektrike dhe mekanike si dhe trajnime për sigurinë në pune.
- b) Nxitja e trajnimeve dhe zhvillimit profesional në të gjitha bizneset dhe institucionet si ato shtetërore dhe private.
- c) Nxitja e bashkëpunime dhe shkëmbimeve me Administratat Publike, Organet Publike, Dhomat e Tregtisë dhe Shoqatat Tregtare dhe çdo institucion tjetër qofte dhe ndërkombëtar;
- d) Ofrimin e një shërbimi të kualifikuar në fushën e projekteve, instalimeve, mirëmbajtjes, asistencës dhe trajnimit në përgjithësi;
- e) Për të përhapur kulturën e sigurisë, trajnimin e punonjësve dhe përdoruesve me kurse te standardit evropian;
- f) Nxitja e shkëmbimit të përvojave ndërmjet kompanive të ndryshme, përmes takimeve, konferencave, seminareve, kongreseve, iniciativave studimore;
- g) Pjesëmarrja ne projekte, hulumtime dhe çdo lloj aktiviteti ose initiative, përfshirë dhe thirrjet për propozime, të promovuara nga ndonjë organ publik ose privat, madje edhe ndërkombëtar;



- h) Ofrimin e asistencës teknike, konsulences dhe ekspertizës të gjitha aktiviteteve private dhe publike.
  - i) Te bashkëpunoj me institucionet edhe organet ndërkombëtare, publike dhe private, ndërtuesit dhe shoqatat e tjera në interes të sektorit;
  - j) Përmirësimi i kualifikimit profesional te punonjësve të sektorit (punëtorët e mirëmbajtjes, montuesit, instaluesit, mësuesit) përmes një sistemi të certifikimit te kualifikimit profesional ne përputhje me standardet teknike te UNI-t.
  - k) Nxitja e etikes profesionale dhe të tregut midis kompanive duke inkurajuar shkëmbimin dhe bashkëpunimin ndërmjet tyre.
  - l) Nxitja e krijimit të organeve të certifikimit në përputhje me konformitetin e kërkuar në fushat e kompetentes;
  - m) Mbrojtja e imazhit dhe interesave për fushën qe përfaqëson, si dhe të gjithë anëtareve të tij;
  - n) Aktivitetet profesionale i referohen fushës se parandalimit dhe mbrojtjes nga zjarri, mbylljeve teknike dhe sigurisë në vendin e punës në funksion të projektimit, montimit, instalimit, mirëmbajtjes dhe trajnimit;
- Shoqëria mund të ushtroje gjithashtu edhe aktivitete të tjera ndihmese në përputhje me legjislacionin në fuqi të konsideruara me përfitim dhe të dobishme për arritjen e objektivave të saj kryesore.
  - Shoqëria ka të drejte të bashkëpunojë me persona juridike ose fizike ose me cilën do tjetër shoqëri me të njëjtin objekt veprimtarie brenda ose jashtë vendit.

#### Neni 4

Shoqëria në bazë të legjislacionit Shqiptar , ka të drejte të hap filiale , dege, përfaqësi dhe të japë përfaqësimin në të gjithë territorin e Republikës të Shqipërisë si dhe jashtë saj në përputhje me legjislacioni e vendeve ku ato do të hapen.

#### Neni 5

Kjo shoqëri tregtare selinë e saj do ta ketë në një apartament në Tiranë , Rr."George W Bush" nd. 29, hyrja 1, ap.7, pranë Ures së Tabakeve , Njesia Administrative nr. 2, kodi Postar 1017.

#### Neni 6

Kohëzgjatja e veprimtarisë te Shoqërisë Tregtare është për një afat të pa caktuar.

#### Neni 7

Kapitali i Shoqerise

Kapitali i Shoqërisë ("Kapitali") është 100.000 (njëqindmijë)leke, me Nr. të përgjithshëm të kuotave 2(dy).


#### Neni 8

Ortaket e shoqërisë Z. Marco ZAMBETTI, z. Nicolo CRIPPA, zotërojne:

- **Marco ZAMBETTI**, 1 (nje)kuote që perfaqeson 50% të kapitalit themeltar , me vlerën 50 000(pesedhjet mije) leke.
- **Nicolo CRIPPA**, 1 (nje)kuote që perfaqeson 50% të kapitalit themeltar , me vlerën 50 000(pesedhjete mije) leke.

#### Neni 9

Pjesët e kapitalit themeltar mund të përfaqësojnë kontribute në para ose në natyre , por asnjëherë në kontribute në shërbime.



Kur pjesët e kapitalit themeltar përfaqësojnë kontribute në natyre, vlerësimi i tyre behet nga një ekspert për kontributet nëpërmjet një raporti që i bashkëngjitet statutit. Eksperti caktohet nga Asambleja e Ortakut.

Shoqëria mund të zmadhojë ose zvogëlojë kapitalin e saj.

#### **Neni 10**

##### Zmadhimi i Kapitalit

Zmadhimi i kapitalit behet me vendim te ortakeve të shoqërisë.

Zmadhimi i kapitalit pjesërisht ose plotësisht me anë të kontributeve në natyre ,behet sipas kërkesave të neneve të Ligjit Nr. 9901, datë 14-04-2008.

Eksperti i autorizuar për kontributet emërohet me vendim perkates.

#### **Neni 11**

##### Zvogëlimi i Kapitalit

Zvogëlimi i kapitalit vendoset nga asambleja e ortakeve, e cila merr vendim ne te njëjtat kushte qe kërkohen për ndryshimin e statutit.

#### **Neni 12**

##### Transferimi i Pjesëve të Kapitalit

Pjesët e kapitalit janë lehtësisht të transferueshme me rruge trashëgimie. Gjithashtu janë lirisht të transferushme ndërmjet bashkëshorteve, si edhe ndërmjet paraardhësve e pasardhësve .

Pjesët e kapitalit janë lehtësisht te transferueshme dhe vendoset nga Asambleja e Zakonshme në përputhje me nenin 87 të ligjit të QKB.

Në rast konflikti , kompetente për zgjidhjen e tij është Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë.

#### **Neni 13**

##### Organizimi dhe Administrimi

Organet drejtuese te shoqërisë janë

-Asambleja e ortakeve

- Administrator i shoqërisë zgjidhet Z. Marco ZAMBETTI, për pese vjet në baze të nenit 95 i ligjit nr. 9901, datë 14.04/2008 "Për Tregetaret dhe Shoqëritë Tregtare".

Administratori emërohet dhe shkarkohet prej asamblesë se Ortakeve, me vendim të ortakeve që përfaqësojnë me tepër se gjysmën e pjesëve të kapitalit themeltar.

Përveç kësaj administratori shkarkohet nga gjykata për shkelje të ligjit me kërkesë të çdo njërit prej ortakeve.

#### **Neni 14**

Organi me i larte i vendim marrjes te shoqërisë është Asambleja e Ortakeve.

Ortakët munde ti delegojnë kompetencat e tyre personave të zgjedhur, Vendimet e tyre evidentohen në një regjistër.

#### **Neni 15**

Asambleja e Ortakeve vendos për çështjet e mëposhtme dhe duke mos u kufizuar vetëm në to:

1. Emërimi ose shkarkimi i administratoreve, eksperteve kontabël të autorizuar dhe likuiduesve.
2. Miratimi i raporteve të administrimit dhe kontrollit .
3. Miratimi i llogarive vjetore dhe ndarjes të fitimit vjetor.
4. Ndryshimi i statutit
5. Ndryshimin e selisë, emërtimin.
6. Zmadhimi dhe zvogëlimi i kapitalit themeltar.
7. Transferimi i pjesëve të kapitalit themeltar tek të tretet.
8. Mbarimi i veprimtarisë të shoqërisë apo likuidimi i saj.
9. Shndërrimi i shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar në një forme tjetër shoqërie tregtare.
10. Sanksionet ndaj Ortakeve të cilët nuk u përgjigjen kërkesave dhe interesave të shoqërisë , që mund të jenë vërejtje, këshillime etj.



### Neni 16

Raporti i administrimit inventari dhe llogarite vjetore redaktohen nga administratori. Asambleja e ortakeve miraton llogarite nëse është e nevojshme pas raportit të eksperteve kontabël te autorizuar , brenda 6 muajve nga mbyllja e vitit financiar. Ortaket e shoqërisë, ka të drejte të marre në çdo moment dokumentet e sipërpërmendura për 3 vitet e fundit financiare. Ata mund të ndihmohet nga eksperti i zgjedhur prej tij , i cili i nënshtrohet detyrimit për ruajtjen e sekretit.

### Neni 17

Në Asamblenë e Përgjithshme , mund të marre vendime të vlefshme vetëm nëse marrin pjese ortaket me të drejte vote që zotërojnë me shume se 30% të kuotave . Në rast kur asambleja e përgjithshme duhet të vendose për çështje të cilat kërkojnë shumicën të kualifikuar ajo mund të mare vendime të vlefshme , nëse ortaket që zotërojnë me shume se gjysmën e numrit total të votave janë të pranishmen personalisht dhe votojnë me shkrese ose elektronik. Në përputhje me nenin 86, 87 të ligjit nr. 9901, datë 14-04-2008 "Për Tregëtarët dhe Shoqëritë Tregtare".

### Neni 18

Ndryshimet në statutin e shoqërisë vendosen nga asambleja e ortakut të vetëm të shoqërisë. Në kushtet e mësipërme Asambleja vendos edhe për çështje të tjera që ligji "Për Tregëtarët dhe Shoqëritë Tregtare" u referohet shprehimisht. Në asnjë rast shumica nuk mund të detyroje një ortak për të rritur angazhimin e tij në kapitalin themeltar të shoqërisë.

### Neni 19

Administrator i shoqërisë është **Z. Marco ZAMBETTI, për pese vjet.**

### Neni 20

Administratori ka të gjitha të kompetencat për të vepruar në marrëdhënie me të tretet në emër dhe për llogari të shoqërisë, në të gjitha rrethanat , me përjashtim të kompetencave , që ligji apo statuti ia jep asamblesë të Ortakut të vetëm të shoqërisë.

Administratori ka të drejte të kryej të gjitha veprimet lidhur me administrimin e shoqërisë.

Administratori ka të drejte të hyje në marrëdhënie kontraktore në emër dhe për llogari të shoqërisë ku përfshihen, dhe duke mos u kufizuar vetëm në :

- a) Ndjekja e te gjithë procedurave administrative lidhur me marrjen e licencave për ushtrimin e aktivitetit, marrjen e lejeve nga organet kompetente ne rast nevojesi per realizimin e interesave te shoqërisë, ne kuadër të marrëdhënieve me organet e pushtetit vendor dhe qendror.
- q) Nënshkrimi i kontratave individuale te punës si dhe zgjidhjen e tyre. Nënshkrimin e kontratave te Furnizimit, agjencisë , pronësisë , shkëmbimit etj, ne kuadër te përmbushjes te objektit te veprimtarisë të shoqërisë .
- r) Te përfaqësoje shoqërinë ne kryerjen e veprimeve bankare me llogarite bankare , qe shoqëria ka pranë bankave te nivelit te dyte ,duke pasur te drejte te kryeje çdo veprim me to si tërheqje ,depozitime , transferime etj.

Administratori gëzon te drejtën e përfaqësimit te shoqërisë ne marrëdhënie me te tretet gjithashtu edhe përpara te gjitha organeve shtetërore ,administrative dhe gjyqësore ,te gjitha instancave. Personat e trete qe do te caktohen si përfaqësues te shoqërisë nëpërmjet prokurës se posaçme te lëshuara nga administratori do te kenë te drejte te veprojnë për emër dhe llogari te shoqërisë, brenda tagrave te percaktuara ne prokure, bazuar ne tagrat qe vete administratori gëzon sipas këtij statuti . Ne te gjitha rastet për çdo tejkallim te kompetencave nga personi i trete ,administratori do te përgjigjet solidarisht me te kundrejt shoqërisë.

Administratori është përgjegjës individualisht ose solidarisht ,sipas rastit , ndaj shoqërisë dhe te tretëve për shkelje te statutit apo fajeve te kryera gjate administrimit te shoqërisë.



### **Neni 21**

Kontrrolli i shoqërisë kryhet nga një ekspert kontabël i autorizuar , i emëruar për çdo vit financiar me mundësi rizgjedhje. Ai caktohet nga Asambleja e Shoqërisë.

### **Neni 22**

Për punonjësit që do të punësohen në shoqërinë Tregtare do të zbatohen aktet ligjore dhe nënligjore të dala për këtë qëllim duke lidhur kontratat e punës me secilin.  
Paga e punës nuk është e kufizuar por ajo nuk mund të jete me e ulet se ajo e përcaktuar me vendime të veçanta të qeverisë.

### **Neni 23**

#### Marrëdhëniet Ekonomiko-Financiare

Viti financiar fillon me datën 1 Janar dhe mbaron me datën 31 Dhjetor të çdo viti .  
Llogarite vjetore ,inventari,raportet e operacionet e vitit financiar dhe raportet e veçanta të hartuara nga administratori dhe eventualisht nga eksperti kontabël ,miratimi i bilanceve dhe i dokumentacionit mbi veprimtarinë vjetore brenda 6 muajve nga mbyllja e vitit financiar.

### **Neni 24**

Pas miratimit të llogarive vjetore dhe evidentimit të ekzistencës të fitimit ,ortaku përcakton pjesën që i takon mbi fitimin ,te cilit i janë zbritur shumat e lëna mënjanë për fondin rezerve të domosdoshëm (jo me pake se 1/20 e fitimit të çdo viti ,deri sa ky fond të arrij vlerën e 1/10 të kapitalit themeltar ) si dhe të jene zbritur ose shtuar respektivisht humbjet e mbartura apo fitimet e mbartura nga vitet e mëparshme.

### **Neni 25**

Llogarite ekonomike dhe ato kontabël mbahen në gjuhën shqipe ,në leke ose në valute të huaja.  
Veprimtaria ekonomike mbahet në baze të akteve ligjore dhe nënligjore të dala për këtë qëllim dhe mbështetet në aktivin dhe pasivin që detyrimisht do të pasqyrohen në bilancet e përpiluara nga ekspertet kontabël të autorizuar të cilët mbajnë përgjegjësi ligjore për punën e tyre.

### **Neni 26**

Shoqëria tregtare ,me qëllim që të bëjë sa më të lehta dhe më të shpejta pagesat me të tretet ,do të hapë llogari bankare në një nga bankat që janë të njohura nga shteti Shqiptar ,vendos ose të huaja ,te cilat do të administrohet nga administratori.

### **Neni 27**

#### Prishja, Likuidimi

Shoqëria priset me vendim të Asamblesë të Ortakeve  
Shoqëria mund të shndërrohet në një nga format e përcaktuara nga ligji sipas shumicës të kërkuar nga ligji për çdo rast konkret .

### **Neni 28**

Shoqëria tregtare hyn në procesin e likuidimit që në momentin e vendosjes për prishjen e saj . Për fillimin e këtij procesi Asambleja e Ortakeve emëron një likuidues i cili paraqet raportin e likuidimit ,gjendjen e aktivitetit të pasivit të shoqërisë ,mbi mënyrën e ndjekjes të operacionit të likuidimit dhe afatin e nevojshëm për përfundimin e tyre.  
Në fund të procesit të likuidimit , Asambleja e Ortakeve vendos mbi bilancin përfundimtar ,mbi aktin dhe rregullsinë e likuidimit ,mbi mbylljen e procesit të likuidimit të shoqërisë .

### **Neni 29**

Të gjitha mosmarrëveshjet që do të lindin gjatë ekzekutimit të këtij statuti dhe kontratës së themelimit gjatë ekzistencës të shoqërisë , si gjatë kryerjes të veprimtarisë ashtu edhe në procesin e likuidimit , do të zgjidhen nga Gjykata e Rrethit Gjyqësorë Tiranë.




**Neni 30**

Të gjitha ndryshimet dhe plotësimet e statutit duhet të kryhen në të njëjtën formë dhe sipas procedurës së njëjte të nevojshme për miratimin e statutit .

**Neni 31**

Ky statut është hartuar në 4 kopje nga të cilat njëra depozitohet në zyrën e noterisë Tirane ,njëra depozitohet në QKB- Tirane , njëra në Zyrën e Tatimeve Tirane dhe kopja e katërt mbahet në dokumentet e shoqërisë .

Marco ZAMBETTI  
MARCO ZAMBETTI



ORTAKET

Nicolo CRIPPA

Nicolo CRIPPA



18.12.18